



Ndërmarrja publike lokale EKO-THERANDA

NPL EKO THERANDA SH.A.

Nr. 15/2026

Data 31.03.2026
SUHAREKË

Adresa: Rruga Brigada 123, Nr.2, 23000 Suharekë NUI:812186999, e-mail: ekotherandasha@gmail.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, Udhëzimit Administrativ 01-2024, si dhe Rregullores për Procedurat e punësimit Nr.01-893/2, date 29.10.2024 Nr.01/2024, në bazë të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të NPL "EKO-THERANDA", nr.12/2025, nenit 26 pika 5 të kësaj rregullore, si dhe në bazë të Vendimit të Bordit të datës: 11.03.2026, Ndërmarrja Publike Lokale EKO-THERANDA Sh.A në Suharekë, shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të punës: Punëtor/e fizik në Shërbimin e Mirëmbajtjes- **4 (kater) pozita**

I raporton: Kryepunëtorit/es në Shërbimin e Mirëmbajtjes

Niveli i pagës (koeficienti): 5.45

Përgatitja profesionale/shkollore: E mesme e ulët/fillore (e preferueshme), shkathtësi në punë.

Përvoja e punës: Se paku gjashtë muaj

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e Kontratës: Me kohë të caktuar 12 muaj me mundësi vazhdimi varësisht nga nënshkrimi i kontratave me komunën (puna provuese 3 muaj)

Vendi Punës: Rr. "Brigada 123" nr.2, 23000 Suharekë (selia e NPL EKO-THERANDA)

Detyrat e përgjegjësitë:

1. Te jete i afte qe me orar te plote dhe pa kufizime te kryej detyrat e punës
2. Kryen të gjitha punët fizike në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave, zbrazjen e kontejnerëve dhe pastrimin e lokacionit për rrethe tyre;
3. Sipas planit operativ dhe planit të punës ditor bënë fshirësen, pastrimin dhe larjen e rrugëve, apo pastrimin e rrugës dhe trotuareve nga bora dhe akulli si dhe hedhjen e kripës;
4. Bënë larjen e automjeteve të ndërmarrjes;
5. Pastrimin dhe menaxhimin e varrezave të qytetit;
6. Ujitja e luleve dhe drunjëve dekorativ në lokacione të ndryshme të qytetit, etj.
7. Bënë largimin e qenve dhe maceve të ngordhura dhe i vendosin ne lokacionin e caktuar;
8. Bën pastrimin e nevojshëm të gjitha hapësirave që disponon ndërmarrja publike lokale "Eko-Theranda" SH.A. në Suharekë;
9. Kujdeset për vendosjen e pajisjeve dhe orendive në vendin e duhur;
10. Kujdeset për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruar në ndërmarrjen publike lokale;
11. Kositjen e barit dhe drunjëve për rrethe rrugëve;
12. Bënë mirëmbajtjen dhe pastrimin e të gjitha objekteve publike dhe private;
13. Është i obliguar te përdorë dhe kujdeset për mjetet përkatëse ne pune;
14. Kryen edhe punë dhe detyra të tjera të caktuara nga Kryeshëfi Ekzekutiv;

Mënyra e aplikimit;

Aplikimi bëhet në mënyrë fizike tek zyra e NPL EKO-THERANDA e cila gjendet në objektin e Komunës së Suharekës Rr.Brigada 123 nr.2 ose në mënyrë elektronike në adresën: ekotherandasha@gmail.com (Dokumentet duhet të dorëzohen në formatin PDF).

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e konkursit do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkangjiten:

- Aplikacioni i NPL EKO-THERANDA i cili merret në zyret e NPL-së;
- Dëshmia e Shkollimit (Nese posedon);
- Jetë Përshkrimi (CV);
- Dëshmia mbi përvojën e punës së paku 6 muaj;
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga Gjykata, e cila dëshmon që nuk jeni i/e dënuar apo nën hetime (duhet të jetë jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Çertifikatën mjekësore që është në gjendje të mirë shëndetësore si fizike ashtu dhe psikike para nënshkrimit të kontratës (vetëm kandidati/ja i/e përzgjedhur)

***Shënim:** Aplikacionet që arrijnë pas afatit të përcaktuar në konkurs dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.*

NPL EKO-THERANDA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë burrë apo grua dhe nga të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës.

Shpallja është e hapur që nga data 01.04.2026 deri më 15.04.2026.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Administratën e NPL EKO-THERANDA e cila gjendet në objektin e Komunës së Suharekës Rr.Brigada 123 nr.2 apo ne email: ekotherandasha@gmail.com

